A.K.P.A.
Nr 2996 Prot.
Datë,më 10 11 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HERMANN GMEINER", TIRANË

Nr.88 Prot.

Tiranë më 10 / 11 2026

**Lënda: Njoftim për vend të lirë .**

**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të Ligjit Nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të Udhëzimit Nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerezore, perberjen e njesise se zhvillimit te institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit te vazhduar profesional te personelit", i ndryshuar;

Shkolla e Mesme Profesionale "Hermann Gmeiner",Tiranë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

**1 (një ) mësimdhënës të Teorisë dhe Praktikës Profesionale në drejtimin Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, zëvëndësim leje lindje.**

**1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme,**

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:**

**a)** të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
**b)** të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
**c)** të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
**d)** të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
**e)** të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
**f)** të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:**

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me kulifikimin profesional të kërkuar.
b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

**2.Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;
b) jetëshkrimin (CV-në);
c) kartën e identitetit;
d) diplomën;
e) librezën e punës;
f) cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) cetifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.
l) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopjo të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të shkollës, brenda datës 18 / 11 /2026.
3.Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të Udhëzimit Nr.759, datë Nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerezore, perberjen e njesise se zhvillimit te institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit te vazhduar profesional te personelit", i ndryshuar .

**DREJTORE**

**HEDIE GJONI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MESME TEKNIKE-ELEKTRIKE "GJERGJ CANCO" TIRANË